



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
SEKTORI I PROKURIMEVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE

Nr. _____ prot.

Himarë , më _____.____.2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i Rruges Kryesore Gjilekë (Vazhdim)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6 Punime ndërtimi për rrugë

VLERA E FONDIT 45,000,000 (dyzetë e pesë milionë lekë) lekë pa TVSH

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha

kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021**, **2022**, dhe **2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar edhe në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** dhe **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti

për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*

- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

▪ **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **NP.1** – Punime Germimi ne toke **Klasifikimi B**
- **N.P. 4** - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale **Klasifikimi A**
- **N.P. 5** Punime nëntokësore, ura e vepra arti **Klasifikimi A**

- **NS-4** – Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese – **Klasifikimi B**
- **N.S -6-** Sinjalistika rrugore jodriqëse **Klasifikimi A**
- **NS-18** – Punime topogjeodezike – **Klasifikimi A**

* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuara	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Punime gërmim dheu, Punime prishje, Punime gërmim shkëmbi i fortesive te ndryshme me ekskavator	B	21-50 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtresa rrugore dhe punime te tipologise se rrugeve dytesore dhe/ose linja te punimeve	A	0-21 milion

NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punime për KUB, KUZ dhe të tjera instalacione të cilat kërkojnë ndërhyrje nëntokësore, vepra arti, ura, muratura etj	A	0-21 milion
NS-4	Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Rifiniture e muratës të përfunduara	B	21-50 milion
NS -6	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Sinjalistike rrugore jodriçuese	A	0-21 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike	A	0-21 milion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)
- **ISO 14001:2015** (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)
- **ISO 39001:2012** (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor)
- **ISO 45001:2018** (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë)
- **BS PASS 99:2012** (Sistem i Menaxhimit të Integruar)

Nese certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesipërme sipas natyrës së punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të

paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësiive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- ISO 39001:2012 (Sistem i Menaxhimi i sigurise se Trafikut Rrugor) Ne vleresimin e AK shihet e nevojsheme pasja e certifikimit ne lidhje me Sistem i Menaxhimi i sigurise se Trafikut Rrugor duke pasur parasysh se ky objekt ne pjesen me te madhe te gjatesise se tij shtrihet pergjat aksit Bypss te qytetit, duke konsideruar pranine e mjeteve te renda teknike te cilat do te hyjne dhe dalin ne kantier dhe objekt, AK kerkon standartine mbrojtjes se perdorueseve te rruges gjate punimeve ne kete objekt.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky qe përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimaldhe menaxhimit e sigurisë në punë. Kjo mund te ndihmojë per të vënë në vend politikat,procedurat dhe kontrollet e nevojshme për cdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- BS PASS 99:2012 (Sistem i Menaxhimit te Integruar). (Në zbatim të Legjislacionit për Prokurimin publik si dhe akteve nënligjore të tij, Standarti i Sistemit të Menaxhimit të Integruar garanton që operatori/operatorët ekonomik përmbushin të gjitha kërkesat standarte brenda të gjitha sistemeve të tyre të brendëshme të menaxhimit duke garantuar që ato auditohen në mënyrë të brendëshme me qëllim uljen e rrishtit nga ana e Autoritetit Kontraktor, përdorimin me efikasitet të burimeve të saj si dhe rritjen e efikasitetit të investimeve të kryera gjatë një viti buxhetor)

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **55** (*pesëdhjetë e pesë*) **punonjës**, me koë të plotë pune, për periudhën **3** (*tre*) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të

punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **55 (pesedhjetë e pese)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahëdrejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik të punimeve si më poshtë:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ORE PUNE MJETE	Tot Ore pune Mjete	Punetori	Tot ore pune
1. PRISHJE								
1	2.426/2	Prishje mur blloqe betoni	m3	380		0	3.3	1,254
SHUMA 1:						0		0
2. PUNIME MURATURE GURI								
2	2.88	Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.R.M-15	m3	400	0.26	104	10	4,000
SHUMA 2:						0		0
3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME								
3	3.405/1	Prishje struktura prej betoni	m3	80	1.505	120	1.75	140
4	3.591	Pusetet kontrolli 1.5x1.5x1 m	copë	16		0	35	560
SHUMA 3:						0		0
4. PUNIME DHEU								
5	2.37/3a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 3.0 km	m3	2260		0		0
SHUMA 4:						0		0
5. PUNIME GERMIMI								
6	3.124/1a	Germim shkëmbi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir 3	m3	2224.7	0.52	1,157		0
7	3.25/c	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e forte.	m3	5		0	5.24	26
8	3.124/1a	Germim shkëmbi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir 3	m3	5	0.52	3		0
9	3.124/1a	Germim shkëmbi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir 3	m3	3	0.52	2		0
10	3.124/1a	Germim shkëmbi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir 3	m3	76	0.52	40		0
SHUMA 5:						0		0
6. PUNIME SHITESASH								
11	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	791	0.14	111	0.34	269
12	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	2370	0.275	652	0.28	664
13	3.204/1	Cilindrim shtrese çakelli t>5cm, per asfaltim	m2	2370	0.041	97		0
14	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	1978	0.085	168	0.1	198
15	3.969/1	Sperkatje me emulsion bituminoz 1 l/m2	m2	1638	0.05	82	0.04	66
16	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	34	0.02	1	0.13	4
17	3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm	m2	117	0.015	2	0.075	9
18	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	5	0.14	1	0.34	2
19	3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm	m2	6	0.015	0.1	0.075	0.5
20	3.193/b	Shtrese zhavor lumi t=20cm, me cilindrim	m2	450	0.055	25	0.19	86
21	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	254	0.275	70	0.28	71
22	3.204/1	Cilindrim shtrese çakelli t>5cm, per asfaltim	m2	254	0.041	10		0
23	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	254	0.085	22	0.1	25
24	3.969/1	Sperkatje me emulsion bituminoz 1 l/m2	m2	254	0.05	13	0.04	10
SHUMA 6:						0		0
7. ANALIZA TEKNIKE								
25	3.226/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	1638	0.017	28	0.095	156
26	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	1638	0.023	38	0.12	197
27	3.226/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	254	0.017	4	0.095	24
28	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	254	0.023	6	0.12	30
SHUMA 7:						0		0
8. PUNIME BETONI E BETONARMEJE								
29	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	780.7	2.29	1,788	12.8	9,993
30	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (2)	m3	106.58	1.3	139	13	1,386
31	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	53	2.29	121	12.8	678
32	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (2)	m3	38	1.3	49	13	494
SHUMA 8:						0		0
9. PUNIME PERFORCIME - KALLEPE - BETONIME E HEKURI PER TUNELE								
33	3.771/e	Transport betoni me autobetonjere 3.0 km	m3	858		0		0
SHUMA 9:						0		0
10. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE								
34	2.523/1	FV Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	ml	168		0	0.242	41
SHUMA 10:						0		0
11. UJESJELLES E KANALIZIM I JASHEM								
35	2.342	Pusetet shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	copë	26		0		0
SHUMA 11:						0		0
12. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA								
36	3.164/1t	FV tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	400		0	1.5	600
37	3.169	FV shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160mm	copë	13		0	1.8	23
38	3.168	FV krahe shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	13	0.1	1	1.2	16

39	3.175	FV ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004,me llampe 250W 230V	copë	13	2	26	2	26
40	3.176	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	13		0	1.9	25
		SHUMA 12:				0		0
		13. INSTALIME PER NDRICIM				0		0
41	2.480/5	FV tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	30		0	0.43	13
42	2.496	FV. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m	copë	13		0	0.3	4
43	2.500	FV. Percjelles Tokezimi , Cu, S=95mm2, i zhveshur	ml	35		0	0.05	2
		SHUMA 13:				0		0
		14. PUNIME TE NDRYSHME				0		0
44	3.654	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 100	m	1185		0	0.31	367
45	3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m2	385		0	2.14	824
		SHUMA 14:				0		0
		15. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT				0		0
46	1.126/p	Bordura betoni 15x35cm	m	453		0	0.88	399
		SHUMA 15:				0		0
		16. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE				0		0
47	3.949	Vizime me boje bikomponente	m2	35	0.5	18	0.5	18
48	3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	860	0.1	86	0.1	86
49	3.952	FV tabela te ndryshme rrugore D=90cm	copë	6		0	0.5	3
50	3.954	FV tabela rrugore treguese 60x20cm	copë	4		0	0.3	1
51	3.956	FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti	copë	2		0	0.3	1
		SHUMA 16:				0		0
		17. ANALIZA TEKNIKE TE REJA 4				0		0
52	4.177	FV. kabell ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x16mm ²	ml	450	0.44	198	0.44	198
		SHUMA 17:				0		0
		18. GAZ E NAFTESJELLES				0		0
53	4.142/2.15	FV.kablllo kontrolli Cu te armuan, ne toke, 4x2.5 mm2	m	50		0		0
					op mjete	5,179	op punetori	22,986
							Punetori	15
								14.4
								55

GRAFIK PUNIMESH

nr tot i listpages

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libeze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 2(dy) **Inxhinier Ndërtimi** (të paktën 1 me profil konstruktor dhe 1 me profil infrastrukturë transporti)
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat

kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

Inxhinieri i Ndërtimit (*me profik Konstruktor*) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv., me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve si dhe duke siguruar qëndrueshmëri fizike të konstruksioneve të beton-arnesw duke siguruar banesat dhe objektet e tjera të cilat ndodhen në gjatësinë e segmentit.

Inxhinieri i Ndërtimit (*me profil infrastrukturë transporti*) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, duke siguruar zbatimin e saktë të projektit dhe duke pasur parasysh Specifikimet Teknike dhe projektin e miratuar, inxhinieri me profil në infrastrukturë transporti çmohet mjaft i nevojshëm në këtë projekt.

Inxhinieri Gjeoteknik, ben ndjekjen e zbatimit të punimeve duke pasur parasysh natyrën e objektit, dhe vlerësuar dhe kontrolluar standartet teknike gjatë nderhyrjes. Gjithashtu duke pasur parasysh raportin gjeologjik të paraqitur nga projektuesi, qëndrueshmëri dhe shtresave rrugore dhe afërsinë me objektet private të banimit, inxhinieri do të bëjë të mundur garantimin e cilësisë së punimeve.

Inxhinier Topograf, i cili do të bëjë piktimin e sakte të objektit dhe me pas vlerësimin topografik të tij, duke pasur në konsideratë vendndodhjen e vështirë të objektit.

Inxhinier Elektrik, i cili do të jetë përgjegjës për punimet në ndriçim rrugor po gjithashtu do të kryejë të gjitha procedurat ligjore për lidhjen me rrjetin elektrik dhe garantimin e sigurisë.

Inxhinieri Hidroteknik, përgjegjës për zbatimin e projektit sipas specifikimeve teknike, duke garantuar funksionalitetin e kapitujve nr 4 dhe Nr 5 të preventivit, konkretisht punimet KUB dhe KUZ, të cilat janë pjesë mjaft e rëndësishme e projektit dhe funksionalitetit të tij. AK e vlerëson të domosdoshëm në këto procese pune.

Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

- b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:
 - c) Teknik i Mesëm Ndërtimi (*me diplomë të shkollës së mesme profesionale*)- jo më pak se **1** (një) punonjës
 - d) Teknik Topograf (*me diplomë të shkollës së mesme profesionale*)- jo më pak se **1** (një) punonjës
 - e) Teknik i Mesëm Mekanik (*me diplomë të shkollës së mesme profesionale*) - jo më pak se **1** (një) punonjës
 - f) Hekurthyes - jo më pak se **4** (katër) punonjës
 - g) Kaperntier - jo më pak se **4** (katër) punonjës
 - h) Betonues – jo më pak se **5** (pesë) punonjës
 - i) Hidroizolues – jo më pak se **1** (një) punonjës
 - j) Asfaltshtrues – jo më pak se **3** (tre) punonjës
 - k) Elektriçist– jo më pak se **3** (tre) punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).

- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen Qershor 2024 - Gusht 2024.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse si dhe emrin e institucionit qe ka leshuar dokumentin per specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik i mesem topograf**, referuar zerave te preventivit dhe projektit te miratuar, tekniku i mesem gjeodet se bashku me inxhinierin do te bejne pozicionimin korekt te objektit duke siguruar qe mbrojtja nga vershimet e perrenjeve te jete maksimale dhe objekti te kete funksionalitet te plote.
- **Teknik i mesem mekanik**, referuar preventivit dhe grafikut të punimeve është i nevojshëm për të siguruar mbarvajtjen e mjeteve të rënda të punës dhe ato teknologjike, duke siguruar

mirëfunksionimin dhe realizimin në kohë të kontratës, gjithashtu duke pasur parasysh mjetet e shumta në kantier.

- **Hidroizulues**, i nevojshëm sipas specifikimeve teknike të bashkëlidhura në projekt, i nevojshëm në faza të ndryshme të procesit të punës dhe mbarëvajtjes së saj duke pasur parasysh punimet për mbrojtjen nga lagështia të strukturave monolite të betonit
- **Karpentier**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të analizave dhe preventivit.
- **Hekurkthyes**, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve të çatisë referuar zërave të analizave dhe preventivit.
- **Betonues**, bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar analizave dhe preventivit.
- **Asfaltoshtrues**, bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar analizave dhe preventivit.
- **Elektriçist**, bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar analizave dhe preventivit.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar në liçencë 1 (një) Punonjës të certifikuar si *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”* gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë 09/06/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/çertifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga

rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- l) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .

- m) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Manovratore/Eskavatoriste – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Manovratore/Buldozerist - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Automakinist – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Shofer – jo më pak se **4 (katër)** punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të përkojë me kërkesat e profilit të dekluar për çdo punojes.

- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, datën e kontratës së punes, numrin e deshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerisë së saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon të drejtën e verifikimit të deklarimeve për punonjësit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kërkesat e mesiperme do të jete kusht për skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr	Makineri dhe pajisje	Gjendja	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Dumper 20-30 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri në 1-2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Motopompe uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Buldozer	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Betoniere Kantieri	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Autobot me sistem pompimi për pastrim të KUZ (pajisur me Lejet mjedisore III.1.A dhe III.2.B)	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Pajisje GPS (me certifikime)	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Pajisje Total Station	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Kamion veteshkarkues me kapacitet 3,5 – 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1

13	Fadrome me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Ekskavator me goma 0.25 m ³	në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Ekskavator me zinxhirë 0.5m ³	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Rrul me dhembe min 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Rrul ngjeshës min 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Vibrator betoni i jashtëm	në pronësi ose me qira	Copë 4
21	Moto gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 55 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 3 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 3 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 25 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

- Dumper 20-30 ton referuar analizave 3.124/1a, 3.124/2a, 3.47/1b
 - Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 1-2 ton, e nevojshme per transporte te ndryshme jashte kantierit
 - Motopompe uji, e nevojshme per heqjen e ujerave te terperta dhe/ose devijime te ndryshme gjate armimit të strukturave monolite të betonit
 - Buldozer
 - Autopompe betoni, e nevojshme per betonime te strukturave tw armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
 - Autobetoniere,e nevojshme per betonime te strukturave tw armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
 - Betoniere Kantieri,e nevojshme per betonime te strukturave tw armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
 - Autobot me sistem pompimi për pastrim të KUZ (paisur me Lejet mjedisore III.1.A dhe III.2.B), e nevojshme për punimet dhe ndërhyrjet në sistemin KUZ, duke garantuar lidhjen e këtij segmenti me segmentin ekzistues të kanalizimeve të ujërave të zeza. Pastrimi I segmentit të mëparshëm dhe lidhja me segmentin e ri do të sigurojë mirëfunktionimin në tërësi të veprës dhe e siguron AK për një jetgjatësi të shtuar të investimit.
 - GPS Geost, e nevojshme per matjet dhe planvendosjen e sakte te objektit
 - Ekskavator me zinxhire, referuar kapitullit 5, punime germimi
 - Kamion veteshkarkues me kapacitet 3,5 – 5 ton, referuar analizes 3.125/a
 - Fadrome me goma, e nevojshme per pune dhe sistemime ne hapesira te ngushta
 - Grejder, i nevojshem per perhapjen e njetratjeshem te shtresave pergjate gjithë segmentit
 - Asfaltoshtruese, per shtrimin e asfaltit dhe binderit
 - Ekskavator me goma, referuar manualit nr 3.47/1b
 - Rrul me dhembe min 15 ton, i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike
 - Rrul ngjeshës min 20 ton,i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike,
 - Vibrator betoni i jashtem, per betonimin e strukturave te armuara
- Moto gjenerator, per funksionimin e paisjeve qe kane nevoje per rryme elektrike ne kantier

2.3.8 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë **1 (një)** Impiantin e prodhimit të betonit, (jo me shume se 40 km larg objektit) dhe duhet të paraqese Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik. Per fabriken e betonit duhet te paraqiten dokumentet e pronesise si akte çdoganimi ose fatura tatimore te blerjes. Ne rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne kete rast operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ligjor qe vereteton pronesine e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto)

Argumetimi teknik per distancën e transportit të betonit Distanca prej 40 km nga objekti argumentohet bazuar në qendrueshmëri (viskozitetin) e materialit të betonit i cili duhet të ruaj parametrat teknik përpara hedhjes në veprë. Nëse distanca e transportit të betonit do të jetë më e madhe se 60 min deri në veprë, kjo do të krijonte dëmim të materialit. Me planvendosje/genplan për të treguar më saktësisht që largësia e kërkuar është e saktë.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019

Argumentimi Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se disponimi në pronesi apo me qera i këtyre fabrikave është një dokument i rendesishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofririn tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave që do të përdoren në punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësive të OE për përmbushjen me sukses të kontratës pasi sasia e produkteve që do të përdoren është e konsiderueshme.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, i Preventivin si dhe analizen e cmimeve për zërat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vëlosur nga secili prej administratoreve përkatës.

Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin Publik" dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do të bashkëngjiten dokumentave të tenderit në SPE.

NJESIA E PROKURIMIT